LIGJ
Nr. 53/2012

PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE NË ÇËSHTJET PENALE ME TASK FORCËN HETIMORE SPECIALE TË EULEX-IT

Në mbështetje të neneve 83 pikat 1 dhe 2, 84 pika 4 dhe 122 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave procedurale për marrëdhëniet juridiksionale në çështjet penale me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it. Autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë i ofrojnë Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it bashkëpunimin e tyre gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen vetëm në masën dhe për kohëzgjatjen e operacioneve të Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, deri në përfundimin e veprimtarisë së saj, sipas përcaktimit në aktet ligjore që rregullojnë funksionimin e kësaj Task Force.

3. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në procedimet e tjera që lidhen me vepra penale, të filluara prej ose që i drejtohen ndonjë autoriteti gjyqësor kosovar, duke përfshirë edhe gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it, me përjashtim të Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it dhe procedimeve penale të filluara ose të kryera prej saj.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Task Forcë Hetimore Speciale e EULEX-it" është organi hetimor i zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) dhe që operon nën autoritetin e misionit të Bashkimit Europian për shtetin ligjor në Kosovë, të emërtuar EULEX KOSOVO që, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse, është pajisur me tagrin e kërkimit, dhënies ose transmetimit të letërkërkesave që vendosin marrëdhënie juridiksionale ndërkombëtare.

b) "Autoritete gjyqësore vendore" janë autoritetet e identifikuara në nenin 7 të këtij ligji.

c) "Letërkërkesë" është forma që përdoret për paraqitjen e kërkesave që vendosin marrëdhënie juridiksionale ndërkombëtare, në përputhje me këtë ligj, si më poshtë:

i) Letërporositë, duke përfshirë njoftimin e akteve, si dhe marrjen e akteve dhe provave të tjera në procedimet penale;

ii) Kërkesat e tjera, duke përfshirë ekstradimin e personave të ndjekur penalisht, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja, transferimin e procedimeve penale dhe transferimin e personave të dënuar.

ç) "Ministër i Drejtësisë" është Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë.

d) "Ministër i Brendshëm" është Ministri i Brendshëm i Republikës së Shqipërisë.

dh) “Shtetas i huaj” është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, në pajtim me legjislacionin në fuqi, nuk është shtetas i Republikës së Shqipërisë.

e) “Shtet dënues” është shteti ku është dënuar një person.

ë) “Shtet i kërkuar” është shteti të cilit i drejtohet një kërkesë.

f) “Shtet kërkues” është shteti, autoriteti kompetent gjyqësor i të cilit paraqet kërkesa që vendosin marrëdhënie juridiksionale ndërkombëtare.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Dispozitat e këtij ligji zbatohen:

a) për procedimet në lidhje me veprat penale, që, në çastin e paraqitjes së kërkesës, janë nën juridiksionin e autoriteteve gjyqësore të shtetit kërkues ose nën juridiksionin e autoriteteve gjyqësore të Republikës së Shqipërisë;

b) për procedimet që janë nën juridiksionin e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut ose të gjykatave të tjera ndërkombëtare, juridiksioni i të cilave është pranuar nga Republika e Shqipërisë.

Neni 4
Bashkërendimi i bashkëpunimit

1. Në emër të Republikës së Shqipërisë, Ministri i Drejtësisë është bashkërenduesi i bashkëpunimit me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it dhe vepron si autoriteti kompetent qendror për marrjen dhe sigurimin e ndjekjes së duhur të kërkesave për bashkëpunim gjyqësor nga Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, me vendim, mund të ngrejë organe të veçanta për zbatimin e bashkëpunimit me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it. Në vendimin për ngritjen e një organi të tillë përcaktohen më hollësisht detyrat dhe detyrimet e tij.

3. Pas transmetimit të një letërkërkese dhe nëse nuk vendoset ndryshe nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, autoritetet e Republikës së Shqipërisë vazhdojnë komunikimin me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm ose drejtpërdrejt, nëse këtë e kërkon Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it. Komunikimi me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it kryhet në gjuhën shqipe dhe/ose në gjuhën angleze.

Neni 5
Rregullat për letërkërkesat

1. Letërkërkesat e Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it trajtohen si tepër konfidenciale. Veçanërisht, nëse është e justifikuar për arsye të konfidencialitetit apo sigurisë, emrat, faktet dhe rrethanat që u referohen veprave penale, që lidhen me procedimet që kryhen nga Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it, mund të redaktohen. Konfidencialiteti duhet të respektohet gjithmonë sipas rregullimit të këtij ligji.

2. Letërkërkesat bëhen vetëm me shkrim dhe, përgjithësisht, përmbajnë:

a) emërtimin e autoritetit që dërgon letërkërkesën dhe autoritetin që i drejtohet letërkërkesa;

b) një përcaktim të saktë të tipit të kërkesës që vendos marrëdhënie juridiksionale ndërkombëtare, duke përfshirë një përshkrim të veprimeve ose aktiviteteve hetimore që duhet të ndërmerren, shkaqet për dërgimin e letërkërkesës dhe bazën ligjore;

c) një referencë të shkurtër për procedimin penal që është duke u kryer dhe ngjarjen penale, së cilës i referohet kërkesa;

ç) përkufizimin ligjor të veprës penale që ndiqet penalisht, si dhe kopje të tekstit të dispozitave të brendshme ligjore që zbatohen;

d) sipas rastit, të dhënat personale, që tregojnë shtetësinë e personit që ka një lidhje me objektin e letërkërkesës, si dhe statusin e tij në procedimin penal;

dh) një deklarim, nëse çështja është urgjente, dhe afatin kohor, brenda të cilit kërkohet ekzekutimi i saj;

e) çdo informacion tjetër që mund të jetë i rëndësishëm për procedurën e ekzekutimit të letërkërkesës.

3. Letërkërkesat e Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it i paraqiten Ministrit të Drejtësisë, i cili konfirmon marrjen e tyre dhe i trajton ato nëpërmjet autoriteteve gjyqësore vendore të përcaktuara nga ligji.

4. Letërkërkesat dorëzohen me korrier diplomatik, me shërbim postar ose dorazi. Ato mund të dorëzohen edhe me çdo mjet tjetër të përshtatshëm teknik, me kusht që marrja të konfirmohet dhe mjeti i dorëzimit të jetë i siguruar.

5. Autoritetet shqiptare trajtojnë dhe ekzekutojnë letërkërkesat pa vonesë.

Neni 6

Autoriteti qendror

1. Përgjigjet për letërkërkesat e Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it transmetohen nga autoritetet gjyqësore vendore, nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.

2. Në rast urgjence, autoritetet gjyqësore kompetente, në bazë të këtij ligji, mund t'i transmetojnë dhe shkëmbejnë letërkërkesat drejtpërdrejt. Në rastin e transmetimit të drejtpërdrejtë të letërkërkesave, autoriteti gjyqësor vendor njofton, njëkohësisht, Ministrin e Drejtësisë.

3. Bashkëpunimi ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it mund të jetë i drejtpërdrejtë dhe pa kaluar nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, për shkaqe të arsyetuara dhe në rrethana specifike. Më pas, mund të thirren takime ndërmjet Ministrit të Drejtësisë, autoriteteve gjyqësore vendore dhe Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, për shkëmbimin e përgjithshëm të informacionit, pa kaluar në hollësi operacionale.

Neni 7

Transmetimi i letërkërkesave tek autoriteti kompetent

1. Ministri i Drejtësisë konfirmon marrjen e letërkërkesave të dërguara nga Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it, që i transmetohen menjëherë Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Prokurori i Përgjithshëm është autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e kërkesave në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Për qëllimet e këtij ligji, Ministri i Brendshëm është përgjegjës për bashkërendimin e ekzekutimit të kërkesave për autoritetet kompetente për zbatimin e ligjit.

Neni 8

Bërja e shtesave te letërkërkesat

1. Prokurori i Përgjithshëm, nëse letërkërkesa nuk përmban informacionin e nevojshëm për ekzekutim dhe mungesa e të cilit do të përbënte shkelje të Kushtetutës ose të parimeve të së drejtës ndërkombëtare, i kërkon drejtpërdrejt Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it ta plotësojë atë. Njëkohësisht vihet në dijeni Ministri i Drejtësisë.

2. Nëse kërkesa fillestare i është drejtuar drejtpërdrejt Prokurorit të Përgjithshëm nga Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it, në pajtim me nenin 13, autoriteti gjyqësor vendor i kërkon drejtpërdrejt Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it ta plotësojë atë.

Neni 9
Refuzimi i letërkërkesave

1. Autoritetet gjyqësore vendore mund të refuzojnë letërkërkesat, vetëm nëse janë në kundërshtim me dispozita të caktuara të Kushtetutës dhe të parimeve të së drejtës ndërkombëtare. Refuzimi i komunikohet Ministrit të Drejtësisë, i cili njofton Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it.

2. Nëse kërkesa fillestare i është drejtuar drejtpërdrejt Prokurorit të Përgjithshëm nga Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it, në pajtim me nenin 13, autoriteti gjyqësor vendor njofton për refuzimin drejtpërdrejt Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it.

3. Autoritetet gjyqësore vendore, në rastin e veprave penale kundër njerëzimit, krimeve të luftës ose krimeve të tjera të rënda kundër vlerave që mbrohen nga e drejta ndërkombëtare, tentativave për kryerjen e tyre, si dhe bashkëpunimi në kryerjen e këtyre veprave penale, nuk mund të refuzojnë letërkërkesat, me shkakun se ato përbëjnë vepra penale me karakter politik.

4. Vendimi për refuzimin e një letërkërkese përmban shkaqet e refuzimit dhe bazën ligjore për këtë.

Neni 10
Reciprociteti

1. Bashkëpunimi i autoriteteve shqiptare me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it bazohet në reciprocitet, ku të dyja palët lehtësojnë, përshpejtojnë dhe trajtojnë me konfidencialitet çdo letërkërkesë, e cila ka të bëjë me hetimet përkatëse.

2. Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë dhe Kryeprokurori i Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it veprojnë si garantues të reciprocitetit.

Neni 11
Analogjia

Në masën që nuk bien në kundërshtim me rregullat e veçanta të vendosura nga ky ligj, rregullat e vendosura nga Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 10 193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, zbatohen për analogji.

Neni 12
Konfidencialiteti

1. Ministri i Drejtësisë dhe autoritetet gjyqësore vendore, me kërkesë të Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, zbatojnë rregullat e ruajtjes së sekretit shtetëror dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në lidhje me informacionin që gjendet në letërkërkesat që merren nga Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it.

2. Ministri i Drejtësisë dhe autoritetet gjyqësore vendore, nëse kërkesa e përmendur në pikën 1 të këtij neni nuk mund të përmbushet, informojnë Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it brenda 5 ditëve. Informacioni është i arsyetuar dhe përmban bazën ligjore për të.

3. Të gjitha autoritetet shqiptare, duke përfshirë organet e zbatimit të ligjit dhe organet e tjera të përfshira drejtpërdrejt ose tërthorazi në ekzekutimin e kërkesave të Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, i nënshtrohen detyrimit rigoroz për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit, për të cilin vihen në dijeni për shkak të detyrës.

Neni 13
Transmetimi i drejtpërdrejtë i letërkërkesave

Përveç mënyrave të transmetimit, të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji, letërkërkesat mund të transmetohen drejtpërdrejt, ndërmjet autoriteteve gjyqësore vendore dhe Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, veçanërisht në rast urgjence. Ministri i Drejtësisë njoftohet, njëkohësisht, në përputhje me rregullat e caktuara sipas këtij ligji.

Neni 14

Privilegjet dhe imunitetet

1. Anëtarët e personelit të Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, nëse janë të pranishëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, kanë të drejtën e privilegjeve dhe imuniteteve funksionale që u jepen diplomatëve, sipas së drejtës ndërkombëtare, në pajtim me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961.

2. Personeli i misionit EULEX KOSOVO dhe sendet e tyre, të cilat nuk i takojnë Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, por të cilët janë të nevojshëm për të marrë pjesë në aktivitetet e Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it në Shqipëri, mbulohen nga të njëjtat privilegje dhe imunitete, të parashikuara sipas pikës 1 të këtij neni, nëse janë të pranishëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Masat e veçanta për pjesëmarrjen e personelit të misionit EULEX KOSOVO në operacionet e Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it në Shqipëri do të rregullohen me akte nënligjore të Ministrit të Drejtësisë ose të organeve të tjera kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

4. Mjediset që zihen përgjithmonë ose përkohësisht nga personeli i renditur sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni janë të pacenueshme. Nëpunësit e Republikës së Shqipërisë nuk hyjnë në to, përveçse me pëlqimin e drejtuesit të misionit EULEX KOSOVO dhe të Kryeprokurorit të Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, ose zëvendësve të tyre në mungesë të tyre. Pasuritë, sendet dhe mjetet e transportit të personelit të përmendur kanë imunitet ndaj kontrollit, bllokimit ose ndonjë forme tjetër ndërhyrjeje.

5. Arkivat dhe dokumentet e personelit, të renditura sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, janë gjithashtu të pacenueshme. Nëse komunikimi ndërmjet këtij personeli dhe Zyrës Qendrore është me korrier, korrieri dhe çanta e vulosur që përmban dokumentet janë të pacenueshme.

6. Nga imunitetet e caktuara nga ky nen mund të hiqet dorë vetëm me pëlqimin e veçantë, me shkrim, të drejtuesit të misionit EULEX KOSOVO dhe në pajtim me rregullat e zbatuara nga ai mision.

KREU II

DISPOZITA OPERACIONALE

Neni 15

Hetimet dhe procedimet e Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it në Shqipëri

1. Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it ka autoritet të pavarur:

a) të dëgjojë dëshmitarë, ekspertë dhe persona të akuzuar në Shqipëri;

b) të këqyrë mjedise;

c) të marrë prova të tjera dhe të mbajë çdo dhe të gjitha materialet që janë të rëndësishme për hetimin dhe gjykimin, në pajtim me këtë ligj;

ç) të ndërmarrë ato veprime dhe aktivitete të tjera, që mund të jenë të nevojshme për përfundimin e hetimit dhe përgatitjen e zhvillimin e ndjekjes penale në gjykim, në pajtim me kufizimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni. Këto veprime mund të ndërmerren, sipas rastit, për përfundimin e hetimit dhe përgatitjen e zhvillimin e ndjekjes penale në gjykim, edhe nëse këto nuk cenojnë vullnetin e lirë të individit.

2. Ministri i Drejtësisë, si rregull i përgjithshëm, vihet në dijeni paraprakisht për afatin dhe objektin e këtyre hetimeve dhe informohet nëse kërkohet marrja e masave shtrënguese gjatë zhvillimit të hetimeve.

3. Autoritetet shqiptare asistojnë anëtarët dhe punonjësit hetues të Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, për aktivitetet e tyre të pavarura në Shqipëri, nëse këtë e kërkon Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it.

4. Nëse veprimet ose aktivitetet hetimore që ndërmerren duhet të mbështeten nga një vendim prokurorie apo gjykate, sipas ligjeve shqiptare, procedohet nëpërmjet një kërkese për ndihmë të ndërsjellë juridike dhe ndihma e kërkuar jepet nga autoritetet kompetente gjyqësore vendore, në pajtim me këtë ligj. Ekzekutimi i çdo veprimi, që kërkon forcë ose kufizon të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, kryhet në pajtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 16

Dispozita procedurale në lidhje me ekzekutimin e kërkesave për ndihmë të ndërsjellë

1. Një kërkesë nga Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it, për të përmbushur kriteret formale, pranohet nëse është në pajtim me parimet themelore të legjislacionit shqiptar për procedurën penale dhe rregullat ndërkombëtare detyruese për autoritetet shqiptare. Pjesëmarrja e avokatit mbrojtës në veprimet e ndihmës së ndërsjellë, si dhe regjistrimi audio ose video i këtyre veprimeve lejohet, nëse këtë e kërkon Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it.

2. Me kërkesë, anëtarët dhe punonjësit hetues të Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it vihen në dijeni për kohën dhe vendin e veprimeve të ndihmës së ndërsjellë, që kërkohen të kryhen nga autoritetet shqiptare. Për më tepër, ata mund të marrin pjesë dhe të kontribuojnë për ekzekutimin e atyre kërkesave për ndihmë të ndërsjellë pa autorizim të veçantë.

3. Në pajtim me legjislacionin shqiptar, ekzekutimi i një kërkese nga Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it për transmetimin e informacionit policor mund të trajtohet drejtpërdrejt nga Ministri i Brendshëm.

Neni 17

Thirrja e personave

1. Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it ka autoritetin për të dorëzuar thirrjet dhe dokumente të tjera pranë personave dhe organeve në Shqipëri drejtpërdrejt, me korrier diplomatik, me shërbim postar ose dorazi.

2. Me kërkesë të Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, në rastet e thirrjeve, autoritetet kompetente gjyqësore vendore u japin dëshmitarëve dhe ekspertëve të thirrur për t'u paraqitur para Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it një paradhënie të arsyeshme për udhëtim, nëse këta persona e kërkojnë këtë pagesë. Paradhënia kërkohet të kthehet nëse dëshmitari ose eksperti nuk ndjek seancën e Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, ose në ndonjë mënyrë tjetër nuk i përmbush detyrat për të cilat është nxjerrë thirrja.

3. Sipas procedurave të rregulluara nga udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, Ministri i Drejtësisë, në bashkëpunim me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it, mund të zbatojë një procedurë të përshpejtuar për rimbursimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera, që mund të bëjnë dëshmitarët ose ekspertët. Këto procedura ad hoc janë të rëndësishme, veçanërisht në rastet kur duhet të garantohen konfidencialiteti dhe siguria.

4. Veprimet e parashikuara sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, që duhet të merren në lidhje me palët e treta, kërkohen nëpërmjet një letërporosie dhe procedurës së saj përkatëse.

Neni 18

Transiti

1. Personat e thirrur nga jashtë shtetit nga Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it ose personat, prania e të cilëve kërkohet te zyra e Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, kanë të drejtën e kalimit lirshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, për këtë qëllim.

2. Autoritetet shqiptare mbështesin, lehtësojnë dhe përshpejtojnë kalimin transit të personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe çdo sendi pasuror që ata kanë me vete, që lidhet me thirrjen ose praninë te zyra e Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it.

Neni 19

Këqyrja e dosjeve dhe transmetimi i kopjeve të dokumenteve të dosjes

Me kërkesë të Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, ndihma e ndërsjellë sigurohet edhe nëpërmjet paraqitjes së objekteve, dosjeve ose kopjeve të dosjeve (fotokopje apo nëpërmjet mjeteve elektronike) dhe dhënies së lejeve për këqyrjen e dosjeve.

Neni 20

Kontrollet

Në rast se Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it kërkon kryerjen e një kontrolli, autoritetet gjyqësore vendore dhe çdo organ tjetër kompetent i Republikës së Shqipërisë, që mund t'i kërkohet të bashkëpunojë në ato aktivitete, do të bashkërendohet nga Prokurori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Ministrin e Drejtësisë.

Neni 21

Prania e Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it në marrjen e provave

1. Autoriteti gjyqësor vendor, me kërkesë specifike të Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, jep informacion për kohën dhe vendin e ekzekutimit të letërkërkesave, nëse Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it nuk është e pranishme dhe nuk merr pjesë drejtpërdrejt në aktivitete.

2. Dispozitat e parashikuara në këtë nen nuk cenojnë prerogativat e parashikuara në nenin 15 të këtij ligji.

Neni 22

Procedura të veçanta

Nëse Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it kërkon përmbushjen e kushteve të veçanta, në lidhje me formën dhe procedurën e ekzekutimit të letërkërkesave, autoritetet gjyqësore vendore veprojnë për t'i përmbushur ato në pajtim me këto kushte, me kusht që kërkesat të mos jenë në kundërshtim me dispozitat themelore të rendit juridik të Republikës së Shqipërisë ose rregullat detyruese të parimeve të së drejtës ndërkombëtare.

Neni 23

Paprekshmëria e personave të thirrur

1. Personat që nuk përmbushin thirrjen e lëshuar nga Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it për paraqitje në procedimet jashtë territorit shqiptar nuk i nënshtrohen masave shtrënguese ose sanksioneve penale. Megjithatë, atyre u kërkohet të japin një justifikim të plotë për mospërmbushjen dhe mund t'u kërkohet të arsyetojnë refuzimin e tyre për paraqitjen.

2. Nëse Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it kërkon paraqitjen personale të një personi, të lirë në territorin ku ky ligj është në fuqi, si dëshmitar ose si ekspert për qëllimet e pyetjes së dyfishtë, ballafaqimit ose hetimit, të njëjtat mjetet ligjore duhet të zbatohen nga autoritetet gjyqësore vendore, në bashkëpunim me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it, për të siguruar paraqitjen e tyre, siç do të ishte e lejueshme në rastin e një thirrjeje për t'u paraqitur para një gjykate shqiptare ose një prokurori shqiptar. Nëse një person është i ndaluar në pritje të një seance pranë një autoriteti gjyqësor vendor, ose nëse ai është dënuar me një dënim me burgim për qëllime të ndalimit korrigjues ose mbrojtës, ai mund të lejohet përkohësisht të mbahet i ndaluar nga autoriteti gjyqësor vendor që bashkëpunon me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it.

3. Nëse autoritetet gjyqësore vendore që bashkëpunojnë me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it thërrasin një dëshmitar ose ekspert me banim a qëndrim jashtë shtetit, dëshmitari ose eksperti,

gjatë qëndrimit në Shqipëri, nuk i nënshtrohet ndjekjes penale për një vepër penale të kryer para hyrjes në territorin shqiptar dhe as nuk dërgohet të vuajë një dënim penal, bazuar në një vendim të brendshëm gjyqësor, të lëshuar para hyrjes në vend.

4. Pika 3 e këtij neni nuk zbatohet, nëse një dëshmitar ose ekspert, pavarësisht mundësisë së dhënë, nuk është larguar nga territori shqiptar brenda 15 ditëve pas njoftimit se prania e tij/saj nuk vazhdon të jetë e nevojshme. Kjo periudhë nuk përfshin periudhën brenda së cilës dëshmitari ose eksperti nuk mund të largohej nga territori shqiptar për shkaqe të ligjshme e të dokumentuara.

Neni 24

Seancat nëpërmjet telefonit, videokonferencës ose lidhjeve të tjera të ngjashme

1. Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it mund t'u drejtojë një kërkesë autoriteteve gjyqësore vendore për marrjen në pyetje, në distancë, të dëshmitarëve ose ekspertëve që janë në territorin e Shqipërisë, nëpërmjet telefonit, videokonferencës ose lidhjeve të tjera të ngjashme.

2. Kërkesa që i drejtohet autoritetit gjyqësor vendor për zhvillimin e seancës nëpërmjet telefonit, videokonferencës ose lidhjeve të tjera të ngjashme, përveç informacionit të parashikuar në nenin 5, përmban:

a) emrin e autoritetit gjyqësor vendor dhe personat e caktuar për zhvillimin e seancës;

b) shkaqet pse nuk është e mundur prania e dëshmitarëve ose ekspertëve.

3. Autoritetet gjyqësore vendore i ekzekutojnë letërkërkesat, që kanë objekt zhvillimin e seancave me telefon, videokonferencë ose lidhje të tjera të ngjashme, nëse:

a) këtë e kërkon Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it;

b) dëshmitarët ose ekspertët nuk duan ose nuk kanë mundësinë të paraqiten personalisht në zyrën e Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it dhe bien dakord për të zhvilluar seancën në këtë formë. Nëse ata refuzojnë, zbatohen rregullat sipas nenit 23.

4. Marrja në pyetje në distancë e dëshmitarëve ose ekspertëve zhvillohet nga autoritetet gjyqësore vendore, në pajtim me rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 25

Kontrolli dhe sekuestrimi i materialeve

1. Me kërkesë të Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, autoritetet gjyqësore vendore mund të vendosin të lejojnë këqyrjen e mjediseve private ose sekuestrimin e materialeve që janë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në lidhje me provat e përcaktuara në letërkërkesat.

2. Këqyrja dhe sekuestrimi ekzekutohen nga autoriteti kompetent gjyqësor vendor, në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Prania e anëtarëve të personelit të Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it dhe personelit tjetër, të renditur sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 14, rregullohet në këtë ligj.

3. Nëse një palë e tretë ka përftuar të drejta në mirëbesim dhe një autoritet shtetëror ose palë e dëmtuar, që ka vendbanimin apo qëndrimin në Shqipëri, pretendon pronësinë mbi materialet, dokumentet ose të ardhurat nga krimet e dyshuara, materialet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni jepen vetëm nëse Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it garanton kthimin e tyre pas përfundimit të procedimit të lidhur me provat.

4. Nëse në Shqipëri tashmë ka filluar procedimi penal, në lidhje me materialet, dokumentet ose të ardhurat nga krimi, ky procedim shtyhet për sa kohë materialet janë të nevojshme për procedimin nga Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it.

5. Procedura e parashikuar në këtë nen nuk cenon prerogativat e parashikuara në nenin 15 të këtij ligji.

Neni 26
Dorëzimi i materialeve të sekuestruara

1. Materialet e sekuestruara, në ekzekutim të letërkërkesës, i dorëzohen Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, kur ajo bën kërkesë për konfiskimin e tyre.

2. Sekuestrimi vazhdon për kohën minimale të mundur për përfundimin e procedimit dhe të drejtat e palëve të treta, që mund të kenë posedim ose pronësi të ligjshme mbi materialet, merren parasysh nga autoriteti procedues.

3. Nëse, në përfundim të procedimit, objektet e sekuestruara i rikthehen pronarit në një gjendje të dëmtuar ose nuk i kthehen atij/asaj brenda 60 ditëve nga mbarimi i gjykimit pranë autoriteteve kompetente të huaja, tek të cilat objektet janë përdorur si provë, pronari zhdëmtohet nga Republika e Shqipërisë. Pretendimi për zhdëmtim paraqitet nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm.

4. Si mjet i fundit, pronari i objekteve mund të paraqesë një pretendim për kompensim brenda 3 vjetëve nga mbarimi përfundimtar i gjykimit para Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it ose pasuesit të tij.

5. Procedura e parashikuar në këtë nen nuk cenon prerogativat e parashikuara në nenin 15 të këtij ligji.

Neni 27
Shtyrja e procedimit të brendshëm

1. Autoriteti gjyqësor vendor mund të shtyjë ose të vendosë kushte për ekzekutimin e procedimit, nëse kjo mund të cenojë zhvillimin e procedimit penal të filluar nga Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it.

2. Autoriteti gjyqësor vendor informon Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it lidhur me shtyrjen ose vendosjen e kushteve për procedimin e brendshëm. Nëse Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it informohet drejtpërdrejt, autoriteti gjyqësor vendor vë në dijeni, njëkohësisht, edhe Ministrin e Drejtësisë.

Neni 28
Shpenzimet

1. Shteti shqiptar, nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, mund të heqë dorë nga rimbursimi i shpenzimeve për ekzekutimin e letërkërkesave nga Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it.

2. Dëshmitarët ose ekspertët që paraqiten në procedime, si pasojë e ekzekutimit të letërkërkesave të Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, kanë të drejtën e rimbursimit për qëndrimin dhe akomodimin, që tregohen si shpenzime procedurale, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale.

Neni 29
Masat paraprake

1. Me kërkesë të Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it dhe në pajtim me legjislacionin e brendshëm, autoriteti gjyqësor vendor merr masat paraprake për ruajtjen e provave, materialeve, dokumenteve, të ardhurave të krimit dhe çdo sendi tjetër pasuror që është i përdorshëm në procedim.

2. Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it mund të kërkojë masa të veçanta për sigurinë dhe konfidencialitetin e provave. Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it mund të marrë një rol të drejtpërdrejtë në ruajtjen dhe mbrojtjen e provave, duke informuar autoritetet gjyqësore vendore dhe Ministrin e Drejtësisë për masat që ndërmerr.

Neni 30
Transmetimi i të dhënave pa kërkesë

Çdo autoriteti shqiptar i kërkohet t’i transmetojë Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it çdo

informacion për veprat penale që kanë lidhje me mandatin e Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, të mbledhura gjatë çdo procedimi penal në Shqipëri.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 31
Transferimi i procedimeve penale nga Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it tek autoritetet kompetente shqiptare

1. Çdo procedim që fillon nga operacionet e Task Forcës Hetimore Speciale të EULEX-it, që vendoset t'u dorëzohet autoriteteve gjyqësore vendore, ose çdo informacion i rëndësishëm për fillimin e një procedimi penal, sipas rregullave të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale të Shqipërisë, i transmetohet Ministrit të Drejtësisë.

2. Ministri i Drejtësisë, nëse procedimi është i pranueshëm, bazuar në kushtet e përcaktuara në nenin 71 dhe nenet vijuese të ligjit nr. 10 193, datë 3.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja për çështjet penale", siguron referimin e procedimit përkatës tek autoritetet kompetente gjyqësore vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it ose organi që e pason ka të drejtën të kërkojë informacione të rregullta për ecurinë e procedimit të transferuar ose procedimit të filluar, mbi bazën e informacionit të marrë nga Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it dhe që kryhet nga autoritetet gjyqësore vendore.

Neni 32
Vlefshmëria e veprimeve për marrjen e provave

Mjetet e marrjes së provave dhe provat e marra nga Task Forca Hetimore Speciale e EULEX-it janë të vlefshme në procedimet penale të njohura në Shqipëri.

Neni 33
Aktet nënligjore

Ministri i Drejtësisë nxjerr aktet nënligjore të kërkuara për ekzekutimin e dispozitave, sipas nenit 17 të këtij ligji. Këto akte nënligjore bazohen në parimin e administrimit të mirë të fondeve dhe procesit të rregullt ligjor.

Neni 34
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare më të parë.

Miratuar në datën 10.5.2012